



## AKT THEMELIMI

### PER SHOQERINE TREGTARE "DON JURGE" SHPK FIER

Ne Fier, sot me date 13.05.2003, une – ELMIRA ÇOBO -konforme ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", beje kete akt themelimi:

Me vullnetin tim te lire themeloj shoqerine tregtare me emertimin "DON JURGE" shpk ,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ortak i vetem i se ciles jam une e quatura Elmira Fatmir Çobo.

Selia dhe qendra e kesaj shoqerise tregtare eshte ne Levan te rrethit Fier.

Kjo shoqeri tregtare krijohet me mjetet financiare prone e ortakut te vetem Elmira Çobol ,me kapital themeltar prej 100000(njeqindmije) leke.

Shoqeria tregtare ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nenshtrohet ne aktivitetin e vet legjislacionit perkates shqiptar.

Kohezgjatja e veprimtarise se saj do te jete permbi 10 vjet pune.

Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerise tregtare eshte:

Sherbime funerale, sherbime mirembajtje e te tjera komunale, pastrim, gjelberim e dekor urban.

Servise, lavazho dhe tregtim pjese kembimi mjetesh te ndryshme.

Bar – bufe – restorante dhe hoteleri.

Veprimtari ne ndertime, projektme e zbatime te ndryshme si objekte civile, ekonomike, sociale, objekte kulluese, rruge, ura e vepra arti, etj kategori te fushes se ndertimit.

Organi me i larte drejtues i shoqerise tregtare "Don Jurge" shpk Fier eshte ortakut i vetem i saj, kjo eshte Elmira Çobo. Po ashtu i njeiti person, pra Elmira Çobo eshte edhe administrator i kesaj shoqerise tregtare.

Ne kete shoqeri tregtare mund te aderojne ortake te rinj, ne kushtet qe do te percaktohen ne marreveshjen e bere me kete rast, e drejte kjo e ortakut te vetem.

Gjithashtu ortakut i vetem ka te drejten te shtoje apo pakesoje objektin e veprimtarise se shoqerise tregtare.

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i ligjshem i kesaj shoqeri tregtare eshte ne favor te ortakut te vetem- Elmira Çobo- ne masen 100 perqind.

Nderkohe ortakut i vetem mbart mbi vehte rrezikun e humbjes deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

Per detyrimet qe kjo shoqeri tregtare mund te kete ndaj personave te tjere juridike apo fizike, pergjigjet me mjetet e veta financiare e materiale.

Per funksionimin sa me normal te shoqerise tregtare do te hartohet statut i saj, ku do parashikohen hollesisht menyra e administrimit e organizimit te saj.

Shoqria tregtare e mbyll aktivitetin e saj ne rastet e parashikuara nga ligjislacionin shqiptar per fushat perkatese si dhe ne statutin e saj.

Shoqëria tregtare "Gllava" shpk Ballsh merr personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

Nje kopje e ketij akt themelimi dhe nje kopje e statutit te shoqerise tregtare ruhen ne Gjykatën e Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

THEMELUESI (ORTAKU I VETEM) I SHOQERISE  
TREGTARE "DON JURGE" SHPK FIER

ELMIRA ÇOBO

*Elmira Çobo*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E RRETHIT FIER  
Nr. 10.04.

Fier, me 20.05.2003

VERTETIM

Ne Fier, sot me date 20.05.2003 perpara meje noteres VEZIRE DUSHI u paraqit znj. **ELMIRA FATMIR ÇOBO**, e vitlindjes 1977, banuese ne qytetin Levan, me kombesi e shtetesi shqiptare, me zotesi te plote per te vepruar, njohur me çertifikate personale 72/44 date 05.05.2003.

Ajo deklaroi se kete akt e ka perpiluar vete dhe me vullnet te plote dhe te lire e nenshkruan ne pranine time si notere, gje qe e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

VEZIRE DUSHI

